



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-055

Prishtinë, më 19 mars 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË TË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 19 MARS 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë, që e miratoi Kryesia.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 12 mars 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave,
4. Ftesa për vizitë zyrtare të kryetarit të Parlamentit të Irlandës së Veriut, z. William Hay, në Kuvendin e Kosovës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 12 mars 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 12 mars 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryetari i njoftoi të pranishmit se komisionet parlamentare, gjatë kësaj jave janë në përgatitje e sipër të raporteve për shqyrtimin e projektligjeve. Ai propozoi që mbledhja plenare të mbahet javën e ardhshme.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, vendosi që mbledhja plenare të mbahet më 29 mars 2012, ndërsa rendi i ditës të caktohet në mbledhjen tjetër të Kryesisë me kryetarët e grupeve parlamentare.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Njoftimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2011

Kryesia u njoftua me vendimin e Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me përzgjedhjen e Auditorit të jashtëm - kompaninë audituese **“DELOITTE”**, Prishtinë, për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2011.

4. Ftesa për vizitë zyrtare të kryetarit të Parlamentit të Irlandës së Veriut, z. William Hay, në Kuvendin e Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me ftesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për ta ftuar në vizitë zyrtare kryetarin e Parlamentit të Irlandës së Veriut, William Hay, bashkë me një delegacion prej pesë vetave, prej datës 27-30 mars 2012.
2. Të gjitha shpenzimet e qëndrimit, akomodimit, transportit lokal, drekat dhe darkat zyrtare, për delegacion e Parlamentit të Irlandës Veriore, gjatë kësaj vizite, përballohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, nënkryetarët e Kuvendit diskutuan lidhur me emërimin e anëtarëve të bordeve të agjencive të pavarura, si dhe për mënyrën e procedimit të raporteve të komisioneve parlamentare lidhur me këtë çështje.

Për këtë çështje diskutuan: kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi dhe nënkryetarët e Kuvendit Sabri Hamiti e Xhavit Haliti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:45** minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale